



Në institucionin e Avokatit të Popullit është paraqitur një ankesë nga shtetasi L.K i cili ka sqaruar se është trashëgimtar testamentar i nënës së tij të ndjerë, testatores Sh.K, e cila ka ndërruar jetë në datë 22.05.2010.

Me testamentin nr.1349 rep., nr.485 kol., datë 20.06.2003 të hartuar përpara noteres publike znj.N.Gj, nëna e tij ka shprehur vullnetin e saj për disponimin e pasurisë në favor të ankuesit L.K.

Në këto kushte, ai i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për lëshimin e dëshmisë testamentare bazuar në nenin 388 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 372 të Kodit Civil.

Me vendimin nr.792, datë 02.04.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, dhënë nga gjyqtar Xheladin Karkini është vendosur:

-Rrëzimi i kërkesës si të pabazuar në prova dhe në ligj.

Kërkuesi është njohur vetëm me shkurtimin e vendimit dhe jo me vendimin e arsyetuar të gjykatës. Prej vitit 2012 e deri më sot ky vendim nuk është zbardhur nga gjykata për t'i dhënë mundësinë nga ana procedurale të mund të ushtrojë të drejtën e ankimit.

Pra, rezulton se prej vitit 2012 e deri më tani, **pas 11 vjetëve**, ky vendim nuk është arsyetuar nga gjyqtari për t'i dhënë të drejtën kërkuesit nga ana procedurale të ankimit në gjykatën e apelit.

Në vijim të hetimit administrativ nga ana e institucionit tonë, në bazë të nenit 63/4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë *“Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”*, si dhe në bazë të nenit 19 gërma “b” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, kemi kërkuar informacion lidhur me arsyetimin e

vendimit nr.792, datë 02.04.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, dhënë nga gjyqtar Xheladin Karkini, si dhe nëse disponohet një kopje e vendimit të arsyetuar të sigluar nga sekretaria gjyqësore të na vihet në dispozicion.

Me shkresën nr.1780/1 prot; dt.02.11.2023 Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan na informon se:

*“Përsa na keni kërkuar informacion nëse vendimi nr.792, datë 02.04.2012, me palë kërkuese L.K, me objekt “Dëshmi trashëgimie”, nga këqyrja e dosjes dhe verifikimi në indekse rezulton se:*

*Në dosje ndodhet vetëm procesverbali i zbardhur i cili është mbajtur më datë 02.04.2012, ndërsa vendimi nuk është arsyetuar nga gjyqtari Xheladin Karkini.”*

Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Xheladin Karkini, është shkarkuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në vitin 2013, pikërisht për arsye që lidhen me zvarritjet e proceseve gjyqësore ku përfshihen edhe arsyetimet e vendimeve gjyqësore që shkonin edhe me vite.

Sa rezulton nga rasti i trajtuar më lart, ankuesi nuk ka paraqitur ankim në gjykatë. Shtetasit në fjalë i është cenuar e drejta e tij për t’u njohur me vendimin e arsyetuar, si dhe mundësia e ankimit të këtij vendimi në gjykatën e apelit prej 11 vitesh, pra e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Në vlerësim të Avokatit të Popullit, e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ligjor është një ndër të drejtat themelore të qytetarëve. Për këtë arsye, e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nuk është dhe nuk duhet të mbetet një e drejtë apo garanci deklarative, por është standard kushtetues, i garantuar dhe sanksionuar në aktet që përcaktojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si në nivel ndërkombëtar (neni 6 i

Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut), ashtu edhe në të drejtën e brendshme (neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë<sup>1</sup>).

Sipas parashikimeve ligjore, praktikës gjyqësore, si dhe doktrinës së të drejtës saktësohet se: vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës.

Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese<sup>2</sup>.

Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i përmbledhur në të ashtuquajturën “shkurtim vendimi”, nuk përmban as analizë ligjore dhe as analizë provash, e për pasojë nuk përmbush standardin kushtetues të mjaftueshmërisë, i tillë që të mbështesë pjesën urdhëruese apo dispozitive të vendimit gjyqësor.

E drejta e aksesit në gjykatë, e drejta për t’u dëgjuar, parimi i barazisë së armëve, parimi i kontradiktoritetit si dhe **detyrimi i gjykatës për arsyetimin e vendimit gjyqësor janë disa nga elementët thelbësorë për një proces të rregullt ligjor.**

Këto të drejta janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave<sup>3</sup>.

---

<sup>1</sup> Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet se:

1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

<sup>2</sup> Vendimet nr.3, datë 26.01.2015; nr.63, datë 23.09.2015 të Gjykatës Kushtetuese

<sup>3</sup> Vendimi nr.39, datë 16.03.2017 i Gjykatës Kushtetuese

E drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është për t'u treguar palëve se ato janë dëgjuar, si dhe iu jep atyre mundësinë ta kundërshtojnë atë.

Gjykatat vazhdimisht kanë theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë.

Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse. Që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë, përfundimisht, qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim<sup>4</sup>.

Një zgjatje e tepruar nga seanca e fundit deri në nxjerrjen e një vendimi të arsyetuar mund të cenojë të drejtën e gjykimit pa vonesa të panevojshme dhe të pengojë mundësinë e palëve për të ushtruar **në mënyrë të efektshme të drejtën e ankimit**. Sa më sipër, si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor, ky parim garanton mbrojtjen e të gjitha palëve në procesin gjyqësor ndaj “vonesave të tepruara procedurale”, që në administrimin e drejtësisë rrezikojnë të drejtat e palëve dhe shtetin e së drejtës.

---

<sup>4</sup> Vendimet nr.8, datë 16.03.2011; nr.23, datë 04.11.2008; nr.11, datë 02.04.2008; nr.7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese

Në çështjen *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, GJEDNJ-ja doli në përfundimin se mosdhënia e një vendimi të arsyetuar për të akuzuarin në kohën e duhur, nuk i dha atij mundësi (kohë e mjete të mjaftueshme) që të paraqiste argumentet e tij për t'u ankuar në Gjykatën e Kasacionit. Kjo cenoi të drejtën për një gjykim të drejtë.

Në referim të vendimeve të GJEDNJ<sup>5</sup>, por edhe praktikës së saj në përgjithësi “case law”, gjykatat vendase kanë detyrimin që të respektojnë parimin e rëndësishëm “*të përfundimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm*”. Një drejtësi jo efikase dhe e vonuar çon në dëmtimin e besimit të qytetarëve tek institucionet e shtetit. Drejtësia e vonuar është e njëjtë me drejtësinë e mohuar (Magna Carta). Një vendim i vonuar madje mund të zhbëjë edhe vetë arsyen për të cilën është dhënë vendimi, pasi dhënia e tij në vonesë, mund të bëjë që ai të jetë krejt i pavlefshëm për palën e interesuar. Siç edhe është parashtruar më sipër në këtë vendim, në çështjet gjyqësore periudha e arsyeshme që merret në konsideratë për zhvillimin e procesit të rregullt ligjor fillon me ngritjen e padisë dhe përfundon kur vendimi i arsyetuar merr formë të prerë.

Sipas jurisprudencës së vazhdueshme të Gjykatës së Strasburgut, e cila pasqyron një parim të lidhur me miradministrimin e drejtësisë, vendimet gjyqësore duhet t'i tregojnë në mënyrë të mjaftueshme arsyet mbi të cilat ato bazohen (*Papon k. Francës* ( vendim pranimiti )<sup>6</sup>).

Kështu, çmojmë se gjykimi i çështjeve në kohë, arsyetimi i vendimeve, si dhe dorëzimi i tyre brenda afateve procedurale, nevojitet të adresohen. Në këtë rast, konstatojmë se është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Nga ana tjetër, është e paarsyeshme dhe e pajustificuar që nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan (sot Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan) nuk janë

---

<sup>5</sup> PGV kundër Italisë, vendimi i GJEDNJ, datë 7.11.2000; **Çështja X kundër Francës, 1998**; Vocaturò kundër Italisë; Cappello kundër Italisë; Darvan kundër Turqisë, 2009; Zimmermann dhe Steinner kundër Zvicrës, datë 13.06.1983; Vendimi K.Klitshe de la Grande kundër Italisë, 27.10.1994; Poiss kundër Austrisë, datë 23.04.1097. Vendimi “Hadjianastassiou kundër Greqisë, 16.12.1992

<sup>6</sup> [https://www.echr.coe.int/Documents/Guide\\_Art\\_6\\_criminal\\_SQI.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_criminal_SQI.pdf)

marrë veprimet e duhura organizative për menaxhimin e problematikës së ngritur nga ankuesi dhe adresimin e saj në kohë për t'i garantuar atij të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Çështjet që kanë të bëjnë me mosarsyetimin në kohë brenda afateve ligjore të vendimeve gjyqësore, për më tepër kur zvarritjet variojnë në disa muaj e madje në vite, gjykojmë se cenojnë rëndë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

Nga ana tjetër, nisur nga ajo çfarë kemi trajtuar më lart, lind si nevojë të përcaktohen mekanizma të cilat të evidentojnë dhe kontrollojnë menaxhimin e situatave të largimit të gjyqtarëve nga detyra, për shkaqe objektive ose subjektive ( shkarkime, dorëheqje etj.), në mënyrë që të merren masat e duhura për të përmbushur detyrimet e tyre, për arsyetimin e vendimeve gjyqësore dhe dorëzimin e tyre në sekretari.

Qëllimi i reformës në drejtësi ishte ai i kthimit të besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë. Për këtë, gjatë reformës u morën vendime me kosto shumë të mëdha si në nivel njerëzor, ashtu edhe në aspektin financiar. Për këtë arsye, duhet të jemi në mënyrë të veçantë të kujdesshëm për të mos lejuar veprime apo fenomene të cilat do të mund të ulin përsëri besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson faktin se nga Këshilli i Lartë Gjyqësor janë zgjidhur problematika të ngjashme, si p.sh lidhur me mosarsyetimin e vendimeve gjyqësore të dhëna nga ish gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, znj. Enkeleida Hoxha (rasti i shtetasit K.Sh).

Për gjithë sa parashtruam, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe të lirive nga administrata publike”*, si dhe në ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për avokatin e*

*Popullit*”, i ndryshuar, neni 21/b në të cilin parashikohet: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen*”:

### **REKOMANDOJMË:**

- Marrjen e masave të nevojshme me qëllim zgjidhjen e problematikës së ankuesit L.K, lidhur me mosarsyetimin e vendimit gjyqësor për një periudhë 11 vjeçare.
- Analizimin e rastit të lartpërmendur, nxjerrjen e përgjegjësiive konkrete për mosadresimin e problematikës dhe cenimin e të drejtave për një proces të rregullt ligjor.
- Marrjen e masave për ngritjen e mekanizmave të posaçëm për kontrollin dhe verifikimin, si dhe hartimin e një rregulloreje ku të përcaktohen detyrimet e gjyqtarëve në rastet e largimit nga detyra, ndër të cilat arsytimi i vendimeve gjyqësore, si dhe mënyrat e menaxhimit të situatave në rast moszbatimi.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar.

***Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,***

**AVOKATI I POPULLIT**

**Erinda BALLANCA**